



K.DH.SH.II.nr.1010/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPT “Haxhijaha” Sh.p.k me seli në Rahovec të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1287/17, të datës 07.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.09.2023, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e paditësit NPT “Haxhijaha” Sh.p.k me seli në Rahovec, e datës 17.12.2020, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1287/17, i datës 07.10.2020, **Vërtetohet**.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa mbetet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/428, i datës 04.07.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës

materiale, me propozimi që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit NPT “Haxhijaha”, ndryshohet aktgjykimi A.nr.1287/17 i datës 07.10.2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Aprovohet kërkesëpapia e paditësit NPT “Haxhijaha”, anulohet aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës nr.01.3.2.2/4 i datës 26.02.2018, obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit NPT “Haxhijaha” Sh.p.k, t’ia paguaj 22,618.22 euro për shkak të eksportit të produktit akcizor ‘verë e kuqe vranac’ ose çështja t’i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës. nr.01.3.2.2/428, i datës 04.07.2017, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, NPT “Haxhijaha” Sh.p.k me seli në Rahovec, për rishqyrtimin e vendimeve R-23217/26.08.2016 të ZBD Prizren.

Me vendimin e lartcekur, është konstatuar se Zyra e Brendshme Doganore Prizren, subjektit në procedurë me rastin e shkarkimit të mallit përmes DUD-ir nr.R-23217/26.08.2016, që kishte hyrë në procedurën e përpunimit të brendshëm përmes DUD-it nr.R-2508/06.10.2012, meqenëse subjekti nuk kishte arritur të bëjë përpunimin e brendshëm të mallit, është detyruar që mallin ta lëshoj në qarkullim përmes regjimit IM4, ku në këtë rast i janë caktuar taksat doganore në fuqi.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 07.10.2020, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, si në vështrim

të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lenë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 01.3.2.2/428 datë 04.07.2017. Në arsyetimin e aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se gjykata nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet e paditësit për të vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar Sektori i Akcizave me rastin e krahasimit me gjendjen e të dhënave sipas Deklaratave Unike Doganore të eksportuar me Deklaratat e lejimit të mallit në qarkullim të lirë. Në procedurën e konfliktit administrativ është obligim ligjor në këtë rast i paditësit që pretendimet e veta t'i argumentoj me prova konkrete materiale, të cilin obligim e parasheh dispozita e nenit 81.F par.1 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222. Në mungesë të ofrimit të fakteve që do t'i kontestonin provat e gjetura nga Sektori për Akciza – Dogana e Kosovës, nga të cilat ka rezultuar se nuk është e mundur të identifikohet malli lëndor që ka dal në qarkullim të lirë, gjykata pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar gjendjen faktike të mallit të eksportuar, që parashihet edhe me Udhëzimin e brendshëm nr.15/2015 neni 4.2. Në rastin konkret me veprimet e tij paditësi nuk ka vepruar sipas kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me ligjin kur paditësit i ka refuzuar kërkesën për kthimin e taksës së akcizës të lëshuar në qarkullim të lirë sipas deklaratës Unike Doganore R23217/26.08.2016.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është marr me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën prove veç e veç dhe te gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme nuk ia ka falur besimin provave të paditësit, me të cilat plotësisht vërtetohet se malli për të cilin është paguar akciza është importuar brenda afatit ligjor prej një viti. Tutje deklarohet se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale neni 4.2 të Udhëzimit të Brendshëm nr.15/2015 për faktin se në këtë udhëzim përcaktohet kthimi i akcizës për mallrat akcizore: gazet e naftës nën kodet tarifore 2711 dhe vajnat e rënda në kodet tarifore 2710196410 dhe 2710196490. Prandaj në rastin konkret ky udhëzim i brendshëm nuk mund të gjej zbatim për produktin akcizor “verë e kuqe vranac”. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime i konsideron si të pabazuara pasi që gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi ka lëshuar mall në qarkullim të lirë pa iu përmbajtur kushteve të autorizimit, pa e njoftuar Doganën e Kosovës për vendosjen e mallit në procedurën e përpunimit dhe shkarkimit të mallit, pastaj autorizimin se malli kontestues ka qenë në procedurë të përpunimit, për t’i vërtetuar pretendimet se malli lëndor ka plotësuar kushtet për kthimin e taksës së akcizës. Prandaj, në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe ballafaqimit të provave, gjykata e shkallës së parë konstaton se Aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr.01.3.2.2/428 i datës 04.07.2017, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe Ligjit për procedurën Administrative, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se

janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.1010/22, me datë 04.09.2023

**Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri**